



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br.Prot. Prot No.	01-4603/13
Data Datum Date	31.12.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.12.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK – 03-3048/13, për z. Kolë Krasniqi – U.D. Dekan në Universitetin e Pejës, për arsy se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3048/13, për zyrtarin e lartë z. Kolë Krasniqi – U.D. Dekan në Universitetin e Pejës, dhe njëkohësisht avokat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Krasniqi së pari është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim, ai ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtarit të lartë ushtron funksionin e Ushtruesit të Detyrës së Dekanit në Universitetin e Pejës, dhe njëkohësisht ushtron profesionin e avokatit.

Zyrtari i lartë publik ka kuptuar situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do të pezulloj detyrën e avokatit, për të vazhduar ushtrimin e funksionit së Ushtruesit të Detyrës së Dekanit.

Pas kësaj, Agjencia ka marrë informacionin zyrtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës se z. Krasniqi i është pranuar pezullimi i ushtrimit të profesionit të avokatit.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shhangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Hasan Preteni

